REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 959/20
Datë/Datum. 17.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL LIPJAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **613-20-6418-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Instalimi dhe monitorimi i sistemit të alarmit publik (kundër thyerjes dhe vjedhjes) në të gjitha IEA-të**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

K.S. BESA SECURITY SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR. JUSUF GËRVALLA NR. 64, PRISHTINË
(Adresa)

PRISHTINË — 10000
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 49 785 685 —
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

DIAMANT HASANI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

prokurimi@besasecurity.com; info@besasecurity.com
(Adresa elektronike)

17.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Vënshkrimi dhe vula)*

"BESA SECURITY" Sh.P.K. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Data e njoftimit për kontratë – **28.10.2020.** Data e dorëzimit të kërkesës për sqarim nga Besa Security – **09.11.2020**, ora **14:42.** Data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim nga Besa Security – **12.11.2020**, ora **15:46.** Afati për dorëzimin e ofertave – **17.11.2020**, ora **14:00.** Koha e planifikuar për hapjen e tenderëve – **17.11.2020**, ora **14:00.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

☐ ☐

Po *Jo*

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Neni 6** – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, i Ligjit Nr. 04/L-042
- **Neni 7** – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi, i Ligjit Nr. 04/L-042
- **Neni 9** – Përcaktimi i Nevojave që Duhet Përmbushur, i Ligjit Nr. 04/L-042
- **Neni 27** – Dosja e Tenderit
- **Neni 28** – Specifikimet Teknike, i Ligjit Nr. 04/L-042
- **Neni 53** – Sigurimi i informatave shtesë për kandidadët dhe tenderuesit – i Ligjit Nr. 04/L-042
- **Neni 108/A** paragrafi **6** – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve – i Ligjit Nr. 04/L-042
- **Pika 39** Sqarimi i Tendereve - Paragrafi **4** - tek Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Pas publikimit të njoftimit për kontratë ne kemi bërë shkarkimin e dosjes së tenderit dhe dokumenteve tjera përcjellëse të publikuara nga AK – Kuvendi Komunal Lipjan – dhe në momentin e leximit/vlerësimit të kërkesave tek specifikimet teknike, kemi parë se AK ka vendosur kritere të cilat janë në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPP-së.

Për më tepër, kemi shfrytëzuar të drejtën për sqarime shtesë nga AK, e pas saj edhe për rishqyrtim, mirëpo AK ka vendosur që të mos i përfill asnjërën prej tyre dhe nuk kemi pranuar përgjigje fare.

Prandaj, pasi që autoriteti kontraktues nuk morri asnjë hap e asnjë vendim drejt kërkesave tona, po iu drejtohemi juve si Organi Shqyrtues i Prokurimit me kërkesat dhe faktet/argumentet si në vijim:

Të nderuar,
AK Kuvendi Komunal Lipjan me datën 28.10.2020 ka publikuar njoftimin për kontratë me titull *Instalimi dhe monitorimi i sistemit të alarmit publik (kundër thyerjes dhe vjedhjes) në të gjitha IEA-të,* me numër të prokurimit *613-20-6418-2-2-1.*

Brenda afatit të kërkesave për sqarime, kemi shfrytëzuar të drejtën tonë për sqarim, pasi që në specifikacionet teknike, autoriteti kontraktues kishte vendosur kritere diskrimunese dhe jo efikase, që bien në ndesh me Nenin 6, 7, 9, 27 dhe 28 të LPP-së. Për këtë pikë, kërkesën tone për sqarim po e bashkangjesim në shtojcën C.

Megjithatë, AK nuk kishte kthyer fare përgjigje. Në ditën e fundit brenda afatit për rishqyrtim, e kemi telefonuar AK për ta pyetur a e kanë parë kërkesën tonë për sqarim dhe kemi kërkuar që të kthejnë një përgjigje – përgjigja e tyre ishte që po e shikojnë tash.
Ne pritëm deri ne ora 15:30 për përgjigje, mirëpo AK nuk reagoi, prandaj, vendosëm që ta dorëzojmë edhe kërkesën për rishqyrtim. Edhe me këto veprime AK ka vepruar kundër Nenit 53 dhe 108/A par 6 të LPP-së.

Sa i përket kërkesave tona që i kemi dorëzuar, ju njoftojmë që Kuvendi Komunal Lipjan ka vendosur kritere diskriminuese dhe të panevojshme. Kanë kërkuar panel të alarmit me 640 zona (640 zona i bie të lidhen 640 pajisje me këtë sistem), ndërsa mesatarja e pajisjeve lidhëse për një shkollë është 16 copë. Përveç që është kërkesë diskriminuese, të cilën veçori nuk e kanë shumica e prodhuesëve të alarmit, është edhe kërkesë që bie ndesh me nenin 6 ekonomiciteti dhe efikasiteti. Për ti përmbushur këto kërkesa, AK mund të kërkoj panel të alarmit me minimum 16 deri 32 zona, apo ndoshta edhe diçka më të madhe, por jo më tepër se 64 zona.

Ky ishte vetëm një shembull. Tutje, të gjitha kërkesat tona tjera në kërkesën për sqarim dhe kërkesën për rishqyrtim kanë të bëjnë më këto kritere që janë diskriminuese dhe të panevojshme dhe eliminojnë konkurrencën e lirë, por në të njëjtën kohë nuk janë ekonomike dhe efikase për autoritetin kontraktues.

Prandaj, kërkojmë nga ju që këtë procedurë ta dërgoni në rivlerësim dhe të bëhen ndryshimet e kërkuara nga autoriteti kontraktues, në mënyrë që të përfshihen të gjithë prodhuesit e sistemeve të alarmit të thyerjes, e njëkohësisht t'iu mundësohet të gjithë operatorëve ekonomik që të tenderojnë në mënyrë të barabartë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë:

- humbja e kontratës me të cilën pësojmë në aspektin financiar
- shpenzimet e përgatitjes dhe analizës së tenderit
- shpenzimet e ankesës
- largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në perspektivë dhe imazh të kompanisë tonë
- fitimi i planifikuar për këtë tender

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
c) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*